



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:025300

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05737029

Ac.nr.427/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Naim Mehulli, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Liridon Maloku anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit G.I. nga fsh....., Komuna e L....., të cilin e përfaqëson kompania e avokatëve “Interlex Associates” L.L.C., përmes avokatit Bejtush Isufi nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencia Pyjore e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokatja shtetërore Ilire Aydogan nga Prishtina, me bazë juridike kompensimi i te ardhurave personale nga marrëdhënia e punës, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës dhe përgjigjen në ankesë të paditësit, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.2340/15, të datës 15.09.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **23.05.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencia Pyjore e Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.2340/15, të datës 15.09.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.2340/15, të datës 15.09.2020, në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit e ka aprovuar të bazuar kërkesëpadinë e paditësit G.I. nga fsh....., Komuna e L..... Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit është detyruar e paditura Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencia Pyjore e Kosovës, që paditësit në emër të pagave të porealizuara t’ia kompensoj të ardhurat personale për periudhën kontestuese nga dt.20.11.2003 e deri me dt.21.01.2007, edhe atë: për pagat neto në lartësi prej 4,286.40 €, me kamatë të cilën e paguajnë bankat vendore si për deponimet për kursim në afat prej 1 vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 15.09.2020, kur është marrë aktgjykimi e deri në pagesën definitive, në emër të kontributit personal në Trustin e Kursimeve Pensionale, në emër të paditësit të paguaj shumën prej 456.50 euro, në emër të tatimit në paga, në Administratën Tatimore të Kosovës, në emër të paditësit të paguaj shumën prej 50.35 euro, si dhe t’ia paguaj paditësit shpenzimet e procedurës në shumë prej 514.40 euro, krejt këto në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të vendimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin e paraparë ligjor, ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditësit për shkak shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa dhe të ndryshohet aktgjykimi i atakuar.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar paditësi me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet në tërësi si e pa bazuar, të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar dhe të detyrohet e paditura që palës paditëse t'ia kompensoj shpenzimet lidhur me përpilimin e kësaj përgjigje në ankesë dhe atë në shumën prej 208 euro, sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, si dhe përgjigjen në ankesë, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 pika (d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi ka ushtruar padi me datë 02.10.2015, e te cilën e ka precizuar në shqyrtimin kryesor se me datë 20.11.2003 Gjykata Komunale e Prishtinës ka marrë aktgjykim me anë të të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vërtetuar se paditësi është larguar nga puna në mënyrë të kundërligjshme dhe e ka obliguar të paditurën që paditësin ta kthejë në vendin e punës. Në kërkesëpadi, paditësi ka kërkuar që të miratohet kërkesëpadija si e bazuar, të detyrohet e paditura që në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë të bëj kompensimin e pagave për paditësin G.I. , duke filluar nga dita e ndërprerjes së marrëdhënie së punës e deri me datën 21.01.2007, si dhe të detyrohet e paditura që në afat prej 15 ditësh nga dita që aktgjykimi të marrë formën e prerë që paditësit ti kompensoj shpenzimet gjyqësore, si dhe ato të përfaqësimit të tarifës së OAK.

Me datë 10.07.2020, paditësi kishte parashtruar para gjykatës parashtrësë për precizim të padisë, ku theksohet se nga ekspertiza e bërë nga eksperti A.B., del se e paditura obligohet që paditësit ti paguaj për periudhën kontestuese pagat e realizuara neto prej 4,,286.40 euro, kontributin pensional për këto paga në shumë prej 456.50 euro, dhe tatimin për këto paga në vlerë prej 50.35 euro, e që gjithsej shuma totale shkon në 4,793.25 euro, dhe ka kërkuar nga gjykata e shkallës së parë që të obligohet e paditura të kryej këto pagesa. Më tutje në parashtrësë, paditësi gjithashtu ka kërkuar që e paditura të detyrohet ti kompensoj kamatën paditësit prej 8% prej datës 21.01.2007 e deri më datën e marrjes së vendimit të gjykatës në shumën që vendos gjykata, si dhe të detyrohet e paditura të bëj kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në vlerë gjithsej prej 374.40 euro, kompensimin e taksave gjyqësore në vlerë prej 30 euro për padi, si dhe kompensimin për nxjerrjen e ekspertizës në vlerë prej 100 euro.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se nuk ka qenë kontestuese fakti se paditësi dhe e paditura kanë qenë në marrëdhënie pune, para se paditësit ti ndërpritej kjo marrëdhënie. Këtë e ka vërtetuar dhe Gjykata Komunale në Prishtinë në aktgjykimin C.nr.188/2001 të datës 20.11.2003, nga ku e ka detyruar të paditurën të paditësin ta kthejë në vendin e punës në të cilin ka qenë ose në një vend të ngjashëm pune, e gjithë kjo në afat prej 8 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimin, nën kanosjen e përmbarrimit me dhunë.

Paditësi në cilësinë e kreditori me datë 09.10.2009 ka bërë propozim për ekzekutim ndaj të paditurës, e cila në cilësinë e debitorit, ku ka kërkuar që të në bazë të aktgjykimin C.nr.188/2001 të datës 20.11.2003 të lejohet përmbarrimi.

Gjykata Komunale në Prishtinë përmes aktvendimit E.nr.838/2009 të datës 11.06.2012 ka vendosur të lejohet përmbarrimi ndaj debitorit dhe të paditurën e ka detyruar që paditësin ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës, ose vend pune të ngjashëm, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, nën kanosje të dënimit për mosekzekutim.

Në aktvendimin E.nr.838/2009 të datës 10.07.2014, Gjykata Themelore në Prishtinë ka aprovuar prapësimin e debitorit, të paditurës të ushtruar ndaj aktvendimit E.nr.838/2009 të datës 11.06.2012, dhe ka abroguar të gjitha veprimet e marra në këtë çështje përmbartimore, me arsyetimin se propozimi për përmbartim i kreditorit është ushtruar jashtë afatit ligjor.

Kurse, sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës CA.nr.2812/2014 të datës 13.08.2014, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se me këtë aktvendim është refuzuar si e pabazuar ankesa e kreditorit, këtu paditësit, kurse aktvendimi E.nr.838/2009 i datës 10.07.2014 është vërtetuar.

Në bazë të provave të administruara, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se paditësi i është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë të kundërligjshme nga e paditura, e që kjo vërtetohet dhe nga aktgjykimi C.nr.188/01 i datës 20.11.2003, i cili është bërë i formës së prerë me datë 22.01.2007. mirëpo, edhe përkundër se e paditura ishte e detyruar ta kthej paditësin në vendin e mëparshëm të punës, ose në ndonjë vend të ngjashëm pune, ajo nuk ka përmbushur këtë detyrë në mënyrë vullnetare. Më tutje, propozimi i paditësit për inicimin e një procedure përmbartimore që të bëhet ekzekutimi i aktgjykimit doli të jetë i ushtruar jashtë afatit të paraparë me ligj.

Nga ekspertiza financiare e ekspertit financiar A.B. i datës 31.03.2020, doli se ekspertiza është kryer duke bërë llogaritjen e pagave të porealizuara, kontributeve pensionale dhe tatimeve të të ardhurave nga data 20.11.2003 kur është nxjerrë aktgjykimi e deri me datën 22.01.2007, kur aktgjykimi ka marrë formën e prerë. Nga kjo ekspertizë është konstatuar se paditësi për këtë periudhë do i takonin 4,286.40 euro pagë neto, vlera shtesë për kontribute prej 456.50 euro, si dhe tatimi mbi të ardhurat personale prej 50.35 euro.

Kësaj ekspertize gjykata i fali besimin e plotë, pasi që e njëjta është hartuar në mënyrë profesionale dhe është në përputhje me provat tjera të administruara.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se edhe përkundër faktit se paditësi ka humbur afatin ligjor për ushtrimin e propozimit për kthimin në punë, ai përsëri ka të drejtë në kompensim të pagave, pasi i është shkaktuar dëm material.

Sipas nenit 13 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/27 i datës 08.10.2001, për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, e cila ka qenë në fuqi në kohën kur paditësi i është ndërprerë marrëdhënia e punës, është përcaktuar se: *“Punëdhënësi u paguan për të njëjtën punë një shumë të barabartë femrave dhe meshkujve, e cila përfshinë pagën/rrogën bazë dhe çdo pagesë ose të ardhur tjetër, që iu paguhet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me para të gatshme ose në natyrë nga punëdhënësi.”* Në nenin 14 pika a) dhe b) të të njëjtës rregullore është paraparë se: *“ Pagat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; dhe (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar.”* Tutje, neni 15 i kësaj rregulloreje ka paraparë se: *“Punëdhënësit do t’ua paguajnë punonjësve të paktën rrogën minimale, rrogën më të ulët në shkallën e pagave të përcaktuar nga Departamenti Administrativ i Shërbimeve Administrative Publike ose nga organi që vjen pas tij.”*

Në këtë rast, mes palëve paditëse është krijuar raport detyrimor, ku paditësi merr rolin e kreditorit, kurse e paditura të debitorit. Sipas nenit 262 paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhënie Detyrimore, përcakton se: *“Kreditori në raportin e detyruar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij.”* Meqë në këtë rast është vërtetuar se e paditura i ka mbetur borxh paditësit për shkak të mos pagesës së pagave për periudhën kontestuese, gjykata ka vendosur si në pikat I dhe II të dispozitivit.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me pretendimet e të paditurës se ia ka njohur paditësit të drejtën e kthimit në punë, doli në konkludim se një pretendim i tillë nuk qëndron. Kjo për faktin se bazuar në dispozitivin e aktgjykimit C.nr.188/2001 të datës 20.11.2003, nuk mund të konkludohet se gjykata ka vendosur edhe për kompensimin e pagave për paditësin. Për më tepër, në qoftë se me aktgjykimin në fjalë do ishte vendosur edhe për kompensimin e pagave ashtu siç pretendon e paditura, atëherë gjykata në procedurë përmbarimore nuk do kishte abroguar në tërësi aktvendimin për lejimin e përmbarimit, por vetëm sa i përket pjesës që ka pasur të bëjë me kthimin në punë.

Për kamatën, gjykata e shkallës së parë ka vendosur në bazë të nenit 277 të LMD-së, dhe si datë nga e cila rrjedhë detyrimi i të paditurës për pagesë të kamatës, gjykata ka caktuar datën e marrjes së aktgjykimit.

Vendimin që pala e paditur të bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e shkallës së parë e ka vendosur duke u bazuar në nenin 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurë Kontestimore.

Sipas nenit 449 të këtij ligji, përcaktohet se: *“1 Shpenzimet procedurale përbëhen nga harxhimet e bëra gjatë dhe lidhur me procesin gjyqësor. 2. Shpenzimet procedurale përfshijnë edhe shpërblimet për punën e avokatit e të personave të tjerë të cilëve ligji u jep të drejtën e shpërblimit.”*

Kurse neni 452 parasheh se: *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblejë të gjitha shpenzimet gjyqësore.”*

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, ngase sipas të paditurës dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptimtë dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna, përkatësisht nuk përmban arsyeje të mjaftueshme për faktet relevante, e gjithashtu për faktet relevante ekzistojnë kundërthënie në mes të asaj se çka thuhet në arsyet e aktgjykimit mbi përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve lidhur me deklaratat e dhëna gjatë procedurës, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pathemeltë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e nenit 160 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyeje të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat duke i kualifikuar në pajtim me normat materiale juridike, ka nxjerrë përfundimin e drejtë lidhur me vendosjen meritore.

E drejta materiale është aplikuar në mënyrë drejtë në raport me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë çështje juridike kontestuese nga ku ka rrjedhur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Pretendimet ankimore të të paditurës e cila ne ankesë ka vlerësuar se paditësi për periudhën kontestuese nuk ka punuar dhe tash me është fakt notor dhe se përderisa nuk ka punuar nuk mund të kompensohet, këto pretendime janë tërësisht të pa bazuara për faktin se në këtë rast baza juridike për kompensimin e pagave të paditësit është krijuar me Aktgjykim e Gjykatës Komunale në Prishtinë datës 20.11.2003 i formës së prer me dt.22.01.2077 e në bazë të cilit vendim paditësi është dashtë te kthehet ne vendin e punës, mirëpo për periudhën kontestuese prej largimit të punës e deri në plotfuqishmerin e aktgjykimit të lartcekur paditësi nuk ishte paguar. Pra me vendimin e lartcekur është vërtetuar kundërligjshmëria e ndërprerjes se marrëdhënies se punës nga ana e të paditurës. Duke qenë se baza juridike e kërkesëpadisë është krijuar me Aktgjykim e Gjykatës Komunale në Prishtinë datës 20.11.2003 i formës së prer me dt.22.01.2077. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur për lartësinë e kërkesëpadisë e cila është vërtetuar me ekspertizë financiare pasi faktet vendimtare për bazueshmërinë e kërkesëpadisë mbështeten në shkresat e lëndës e në veçanti vendimi i lartcekur, e i cili eshte i formës së prer, ku në bazë të së cilit është vërtetuar se e paditura në mënyrë të kundërligjshme ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës, duke i shkaktuar kështu paditësit dëm material në shumën e parave të pasqyruara në si në ekspertizë financiare. Për më shumë, si rezultat nga shkresat e lëndës e paditura nuk e ka kundërshtuar substancialisht raportin e ekspertit financiarë dhe as nuk ka propozuar ndonjë provë me të cilën do të vërtetohej gjendja tjetër faktike që eventualisht do të kishte ndikuar në lartësinë e kërkesëpadisë.

Bazuar në vendim e lartcekur paditësit i është njohur e drejta nga marrëdhënia, që nënkupton se bazuar në aktgjykimin e lartcekur ka qenë obligimi i të paditurës që paditëses ti ofroj punë, dhe mos sistemimi dhe mos realizimi i të ardhurave personale për këtë periudhë është me fajin e të paditurës, ku pala paditëse është e dëmtuar me mohimin e realizimit të ardhurave personale, andaj paditësit i takon kompensimi ashtu siç është përcaktuar në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, bazuar në dispozitën e nenit 189 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD - 1978).

Në raport me kamatën drejt është vendosur nga ana e gjykatës së shkallës së parë pasi që dëmi është shkaktuar në kohën kur ka qenë në fuqi LMD e vitit 1978, dhe lartësia e kamatës ka qenë si për mjetet e depozituara pa destinim të caktuar për një periudhë njëvjeçare.

Gjykata e shkallë së parë drejtë ka vendosur edhe në raport me shpenzimet e procedurës meqenëse, pala paditëse e ka fituar kontestin të njëjtës i takon kompensimi i shpenzimeve të krijuara dhe në lartësinë me tarifën e Avokatëve të Kosovës e në përputhje me nenin 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo konsideroi se të njëjtat janë të pa themelta dhe se e paditura me asnjë fakt apo provë nuk i ka bërë të besueshme pretendimet e saj me ankesë, ashtu që kjo Gjykatë të merrte vendim ndryshe nga ai sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.427/2021 të datës 23.05.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Naim Mehulli